



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 09.10. 2023

Lënda: Njoftim për shpallje konkursi për 1 (një) pozicion pune në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE

KËTU

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, neni 50, në Rregulloren e UST-së, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 67, datë 29.09.2023 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë”, shpall kriteret për 1 (një) vend pune për personel administrativ, me kohë të plotë “Drejtor” në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

- I. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për “**Drejtor**” në **Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse** janë si më poshtë:

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

1. Arsimimi: Kandidati që konkuron në pozicionin e punës duhet të zotërojë së paku diplomë të nivelit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të në fushën e drejtësisë ose ekonomikut.
2. Përvoja: Të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion.

3. Tjetër: Njohuri të legjislacionit dhe procedurave të tjera administrative e juridike, njohuri në prokurimet publike.

Vlerësimi i Intervistës.

1. Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.
2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
 - a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Një kopje jetëshkrimi;
3. Diplomë e shkollës së lartë dhe certifikatë notash e noterizuar;
 - Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njëhsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
 - Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë atë të konvertuar sipas sistemit shqiptar;
4. Diploma e certifikata të ndryshme të kualifikimeve të noterizuara;
5. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj të noterizuar;
6. Dëshmi penaliteti/formular vetëdeklarimi;
7. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga institucioni ku ka punuar;
8. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm;
9. Certifikatë personale.
10. Certifikatë familjare.

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, dorëzohet me postë sipas afateve të shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

IV . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Drejtoria, emri, mbiemri, adresa e konkurentit.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.
- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT